



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 01/380 Dt. 10 / 05 /2016

Rektori

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

RREGULLORE

PËR PROCEDURAT E SIGURIMIT TË CILËSISË

Gjilan, 2016

Në bazë të nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit për Arsimin e Lartë, nr.04/L-037 dhe në mbështetje të nenit 49 pika 1.3 dhe nenit 186, 187 dhe 188 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan, Senati i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më datën 8.01.2016, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PROCEDURAT E SIGURIMIT TË CILËSISË

I. Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Me dispozitat e kësaj Rregulloreje përcaktohen standardet, procedurat dhe metodat e sigurimit të cilësisë dhe të vlerësimit të kualitetit të punës së mësimdhënësve, në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjiilan (në tekstin e mëtejme Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan).

Neni 2

Me këtë Rregullore përcaktohet sigurimi dhe vetëvlerësimi e cilësisë në këto fusha:

- » Strategjia për sigurimin e kualitetit;
- » Strukturat organizative për sigurimin e kualitetit;
- » Subjektet e sigurimit të cilësisë
- » Programet studimore;
- » Procesi arsimor;
- » Puna arsimore dhe shkencore - hulumtuese;
- » Resurset njerëzore (stafi akademik dhe jo akademik);
- » Studentët;
- » Tekstet shkollore, literatura, biblioteka dhe kabinetet e informatikës
- » Menaxhimi me Universitetin dhe përkrahja jo arsimore;
- » Ambienti (hapësira arsimore) dhe pajisjet;
- » Financimi;
- » Përfshirja e studentëve në procesin e sigurimit dhe përparimit të kualitetit të punës.

II. Qëllimet e vetëvlerësimit

Neni 3

Vetëvlerësimi, si hap i parë në procesin e vlerësimit të cilësisë dhe të kualitetit, ka disa qëllime kryesore:

- të paraqes një pasqyrë të shkurtër dhe përmbajtjesore të procesit mësimor -arsimor të Universitetit dhe të programeve studimore;
- » të analizojë ndërlidhjen e procesit mësimor-arsimor dhe veprimtarisë shkencore hulumtuese
- » të institucionit;
- ta analizojë strukturën, kualitetin dhe përparimin e kuadrit akademik;
- » ti analizojë anët e mira dhe të dobëta të institucionit të arsimit të lartë, i cili kryen veprimtari të arsimit të lartë, me zbatimin e SWOT Analizës;
- » të sigurojë bazë e cila do të shërbejë për kryerjen e vlerësimit që e realizon
- » Institucioni;
- » të sigurojë bazën e cila do të shërbejë për kryerjen e vlerësimit të jashtëm;

Neni 4

Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan e realizon vetëvlerësimin e programeve studimore në të gjitha shkallët e arsimit të lartë. Me vetëvlerësim e programeve studimore bëhet vlerësimi i kualitetit të veprimtarisë së arsimit të lartë dhe ati shkencor, përmes procedurave eksplicite për vlerësimin e kualitetit dhe kuadrit akademik.

Me vlerësimin e programit studimor duhet të përcaktohet se a i përgjigjet ai standardeve të pranura të Asociacionit Evropian për Sigurimin e Kualitetit (ENQA) dhe a korrespondon me praktikën internacionale. Duhet të vlerësohet se a mundëson struktura e programit studimor integrim të studentëve dhe profesionistëve të diplomuar në sistemet arsimore të vendeve të tjera të Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë.

Neni 5

Përcaktimi për sigurimin dhe përparim të cilësisë së mësimdhënies në Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan realizohet nëpërmes elementeve vijuese:

- » Miratimin e Strategjisë për sigurimin e kualitetit të mësimdhënies, nga ana e Këshillit Mësimor Shkencor, e cila është publike dhe subjekt i hulumtimit periodik;
- » Miratimin e Politikës kualitative, nga ana e Këshillit Mësimor Shkencor të Universitetit, e cila është publike dhe subjekt i hulumtimit periodik;
- » Ndërtimin e sistemit për sigurimin e cilësisë, duke përfshirë në mes të tjerave edhe krijimin e organeve përgjegjëse, standardeve dhe parimeve për sigurimin e kualitetit, si dhe definimin e qartë të roleve të të gjithë subjekteve në këtë proces;
- » Planifikimin e aktiviteteve në fushat dhe aspektet me rëndësi të madhe për sigurimin e kualitetit të mësimdhënies, e veçanërisht lidhur me procesin mësimor, punën shkencore – hulumtuese, studimet më efikase dhe resurseve financiare;
- » Përcjelljen e vazhdueshme dhe grumbullimi sistematik i të dhënave për sigurimin e kualitetit, nëpërmes të organizimit dhe krahasimit të hulumtimeve periodike në të gjitha fushat e punës dhe krahasimi i rezultateve të fituara me planifikimin e bërë
- » Organizimin dhe krahasimin e hulumtimeve periodike të vet standardeve dhe procedurave për sigurimin e kualitetit, me qëllim të përparimit.

III. Misioni i vetëvlerësimit

Neni 6

Misioni i vetëvlerësimit është përcaktimi i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan se çfarë kuadri do të edukojë, për cilat nevoja dhe lëmi të shoqërisë, për tregun e kuadrove të arsimit të lartë në vend dhe jashtë, si dhe i përcakton drejtimet e veprimtarisë shkencore dhe hulumtuese.

IV. Subjektet e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit

Neni 7

Subjekt të sigurimit të cilësisë dhe të vlerësimit në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjiilan janë: ligjëruesit, punëtorët shkencor dhe hulumtues, bashkëpunëtorët, Këshilli Mësimor Shkencor, Komisionet e Universitetit, studentët, stafi joakademik dhe shërbimet administrative.

Me këtë Rregullore përcaktohen funksionet themelore dhe marrëdhëniet reciproke të të gjithë subjekteve në procesin sigurimit të cilësisë dhe të kualitetit, me qëllim të sigurimit konsistentë, efikas dhe efektiv të sistemit për sigurimin e kualitetit të punës në Universitet.

V. Komisioni për vlerësimin e cilësisë

Neni 8

Komisioni për sigurimin e cilësisë është organ kompetent për përcjelljen vazhdueshme dhe sistematike si dhe grumbullimin e të dhënave rreth cilësisë, nëpërmes organizimit të hulumtimit periodik në të gjitha fushat e sigurimit të kualitetit, me qëllim të sigurimit dhe vetëvlerësimit të cilësisë së punës së universitetit.

Anëtarët e Komisionit zgjidhen me votim të fshehtë në mbledhjen e Këshillit Mësimor-Shkencor, nga radhët: e anëtarëve të Zyrës për Sigurimin e Cilësisë, mësimdhënësve dhe studentëve, për periudhë katërvjeçare. Pas zgjedhjes së anëtarëve bëhet konstituimi i komisionit, nga të cilët njëri anëtar zgjidhet si kryetar dhe njëri zëvendës kryetar i komisionit.

Struktura e anëtarëve të Komisionit duhet ti shpreh këto karakteristika:

- » të prezantohet secila strukturë kryesore e Institutit (kuadri akademik, studentët dhe administrata) që të sigurohet pjesëmarrje maksimale në vetëvlerësim të të gjithë subjekteve të interesuara;
- » ti përfaqësoj pikëpamjet e gjera të Universitetin “Kadri Zeka” në Gjiilan, dhe

- » anëtarët e komisionit për vlerësim të jenë në gjendje ti vlerësojnë anët e dobëta dhe të mira të Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan.

Neni 9

Me procesin për sigurimin dhe vetëvlerësimin e cilësisë dhe të kualitetit nënkuptojnë aplikimin e vlerësimit të rregullt dhe të veçantë. Komisioni për sigurimin e cilësisë përgatit planet për implementimin e të gjitha aspekteve të vlerësimit, duke përfshirë lëmin e hulumtimit, angazhimin e subjekteve dhe planin e punës si dhe i raporton Këshillit Mësimor Shkencor për rezultatet e treguara të vetëvlerësimit, me propozime konkrete për ndërmarrjen e masave preventive, nëse kjo është e domosdoshme. Procesi I vlerësimit krijohet në bazë të analizave të dokumenteve dhe informatave rëndësishme, krahasimit të planit të veprimit si dhe në grumbullimin e qëndrimeve dhe të dhënave të subjekteve në sistemin e sigurimit të cilësisë dhe të kualitetit nëpërmes të anketimit.

Komisioni për sigurimin e cilësisë përgatit raportin me rezultatet e vlerësimit dhe ia dërgon Këshillit Mësimor Shkencor, i cili e vlerëson kualitetin e punës në sektor të caktuar të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan me propozime e masa për heqjen e pengesave në përparimin e kualitetit të punës.

Neni 10

Vlerësimi i rregullt i cilësisë kryhet së paku një herë në vit gjatë vitit akademik dhe përfshinë fushat vijuese:

- » programet studimore;
- » procesi arsimor;
- » stafi akademik dhe jo akademik;
- » studentët;
- » librat shkollor, literatura, biblioteka dhe kabineti i informatikës;
- » financimi;
- » organizimi dhe funksionimi i sistemit për sigurimin e cilësisë.

Komisioni për vlerësimin e cilësisë, mund të organizojë vlerësimin e veçantë, me propozim të Këshillit Mësimor Shkencor, me qëllim të vlerësimit të kualitetit në fushat e caktuara të sigurimit të cilësisë, për të cilat vlerësohet se janë të një rëndësie të veçantë për sigurimin e kualitetit të punës në tërësi.

VI. Të drejtat dhe obligimet e Kryetarit dhe të anëtarëve të Komisionit për vetëvlerësim

Neni 11

Kryetari i Komisionit për vetëvlerësim:

- » Planifikon, organizon dhe koordinon punën e Komisionit;
- » Përkujdeset që të mundësoj diskutim të gjerë për vetëvlerësim, me qëllim krijimin e një raporti të pranueshëm tërësisht për vetëvlerësim;
- » Realizon komunikim zyrtar e organet e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan si dhe me Agjencin e Kosovës për Akreditim (AKA), dhe;
- » Kryen punë të tjera në lidhje me realizimin e vetëvlerësimit.

Neni 12

Anëtarët e komisionit për vlerësim kanë të drejtë dhe obligim që aktivisht të marrin pjesë në punën komisionit, sa më gjerësisht që është e mundur të realizojnë kontakte dhe të prezantojnë mendimet e anëtarëve të bashkësisë akademike, si dhe të jenë në gjendje ti vlerësojnë anët e dobëta dhe të forta të funksionimit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan.

Neni 13

Komisioni për vlerësimin e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, mund të formoj grupet e veta punuese me përfaqësues të studentëve të cilëve mund ti besohen punë dhe çështje të caktuara specifike, siç janë: vlerësimi i programeve të caktuara studimore, kontrolli i resurseve dhe financave, trajnimi i kuadrit akademik dhe bashkëpunues dhe zhvillimi i tyre, shërbimet e studentëve, bashkëpunimi i jashtëm, aktivitetet ndërkombëtare e të ngjashme. Komisioni për vlerësim ka obligim të marrë pjesë në trajnim të organizuar nga komisioni për vlerësim të universitetit, si dhe të organizoj trajnim për vetëvlerësim për pjesëmarrësit e tjerë në procesin e vetëvlerësimit.

VII. Planifikimi

Neni 14

Me qëllim të realizimit të misionit, Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan për çdo vit akademik, planifikon të gjitha aktivitetet me rëndësi për sigurimin e kualitetit dhe të cilësisë. Propozim Plani i Punës në vitin akademik e përgatit Rektori i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, para fillimit të vitit të ri akademik dhe ia dërgon Këshillit Mësimor Shkencor për miratim.

Plani i punës për vitin akademik përmban fushat vijuese:

- » procesi arsimor: numri i nevojshëm i profesorëve dhe bashkëpunëtorëve, planet e punës dhe planet operative për çdo lëndë;
- » studentët: numri i studentëve sipas viteve, indikacionet për studime të suksesshme;

- » Puna shkencore - hulumtuese dhe arsimore si dhe veprimtaria botuese, planifikimi i projekteve dhe i publikimeve;
- » Biblioteka: sigurimin e botimeve të reja;
- » Hapësira dhe pajisjet: të nevojshme pajisjet themelore për punë;
- » Vetëvlerësimi i cilësisë (ashtu siç është përcaktuar me këtë Rregullore)

VIII. Cilësia e Programeve Studimore

Neni 15

Cilësia e programeve studimore sigurohet nëpërmes krijimit dhe përgatitjes së standardeve të posaçme dhe mekanizmave të përshtatshëm, me qëllim të:

- » Realizimit të misionit dhe vizionit në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan;
- » Realizimit të qëllimeve të programeve studimore;
- » Përparimit dhe efikasitetit të studimeve;
- » Modernizimin e përmbajtjes së programeve studimore;
- » Grumbullimin e vazhdueshëm të informatave nga subjektet për sigurimin e kualitetit, lidhur me vlerësimin e kualitetit të programeve studimore.

Neni 16

Komisioni për vlerësimin e cilësisë, përcjell cilësinë e nivelit të programeve studimore, sipas udhëzimeve të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për aplikimin e standardeve për Arsim të Lartë, e veçanërisht në:

- » Hartimi i Programeve studimore në bazë të arritjeve më të reja me aftësi konkurruese;
- » Pajtueshmëria me nevojat e përparuara të shoqërisë, në bazë të grumbullimit të informatave të përshtatshme nga institucionet e jashtme;
- » Krahasimi me programet e jashtme studimore, prej të cilave më së paku dy duhet të jenë nga hapësira evropiane e arsimit në secilin program studimor, në bazë të grumbullimit të informatave të përshtatshme nga institucionet e jashtme.

Neni 17

Komisioni për vlerësimin e cilësisë dhe të kualitetit e përcjell efikasitetin e studimeve sipas programeve ekzistuese të studimeve, në bazë të dhënave të cilat i grumbullon Shërbimi i studentëve. Efikasiteti i studimeve matet sipas dhënave vijuese:

- » përqindja e kalueshmërisë së studentëve nga një vit në tjetrin;
- » mesatarja e notave sipas viteve të studimit;
- » numri i studentëve të diplomuar;
- » mesatarja e notave të studentëve të diplomuar në të gjitha nivelet e studimeve;
- » pjesëmarrja e studentëve të diplomuar në krahasim me numrin e studentëve të regjistruar në çdo program studimor;

- » mesatarja e kohës së studimeve për çdo program studimor.

IX. Cilësia e Procesit Mësimor

Neni 18

Cilësia e procesit mësimor sigurohet nëpërmes:

- a) organizimit, përgatitjes dhe ndarjes së procesit mësimor në atë mënyrë që studenti:
 - » zhvillon aftësitë komunikative dhe interactive aplikimin e koncepteve teorike themelore;
 - » zhvillon aftësitë të cilat do ti mundësojnë studentit që pavarësisht të punojë dhe të arrijë njohuri të reja;
 - » në ekip të jetë anëtarë përgjegjës;
 - » përparojnë aftësitë e mendimit dhe zgjidhjes së problemeve;
 - » zhvillon aftësitë e integritetit të njohurive.
- b) Sigurimin e cilësisë së stafit akademik dhe joakademik, veçanërisht sigurimin e raporteve profesionale në punë me studentë dhe sigurimin e kushteve të përshtatshme për punën kërkimore dhe hulumtuese dhe përsosshmërinë arsimore;
- c) Sigurimin e numrit të nevojshëm të ligjëruesve dhe bashkëpunëtorëve dhe veçanërisht atyre me punë me orar të plotë të punës si dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e qetë të ligjëratave, në nivelin e planifikuar, e tillë që ligjëruesi të ketë 6 orë në javë dhe bashkëpunëtori 10 orë në javë.
- d) Sigurimin e kualitetit të fondit të librave në bibliotekë si dhe të gjithë hapësirës së mjaftueshme në të;
- e) Vlerësimin e vazhdueshëm të vlerësimit të cilësisë dhe të kualitetit në këtë fushë, ashtu siç është përcaktuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

Neni 19

Me qëllim të sigurimit të cilësisë, teknikat e organizimit dhe përgatitjes së procesit mësimor përfshijnë definimin para fillimit të semestrit të planit mësimor, (ligjëratat dhe ushtrimet) planit të punës për çdo lëndë që është në atë semestër si dhe plani I organizimit të provimeve. Planet e tilla i vendosen studentëve në shikim, më së largu ditën e parë të fillimit të semestrit, me përjashtim të planit për organizimin e provimeve, i cili mund të përgatitet më së largu 8 ditë para fillimit të afatit të provimeve.

Neni 20

Planin për zhvillimin e procesit mësimor si dhe planin për organizimin e provimeve e përgatit Rektori i Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan, duke marr parasysh mundësitë dhe kërkesat e

studentëve, ngarkesën sipas lëndëve, shfrytëzimin efikas të hapësirës së Institutit dhe faktorët e tjerë. Shërbimi i studentëve duhet të jetë azhur në vendosjen e planit për zhvillimin e procesit mësimor dhe të orareve të ligjëratave e të provimeve në tabelat e shpalljeve si dhe në Ueb faqen elektronike të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan.

Neni 21

Komisioni për vlerësimin e cilësisë, në procesin e vlerësimit të rregullt, nëpërmes anketimit, grumbullon qëndrimet dhe të dhënat për ligjëruesit dhe bashkëpunëtorët, në aspektet vijuese të vlerësimit të procesit mësimor:

- » sigurimi i informacioneve të rëndësishme për procesin mësimor;
- » mbajtjen e ligjëratave, kollokuiumeve dhe provimeve, në pajtim me planin e paraparë;
- » mbajtjen e raporteve profesionale të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve dhe stafit jo akademik në raport me studentët;
- » mundësive të arritjes së aftësive dhe të njohurive të mjaftueshme gjatë procesit mësimor në lëndët e caktuara, në pajtim me planin.

Lidhur me këtë, Komisioni përgatit raport për anketimin e zhvilluar, të cilin ia dorëzon Këshillit Mësimor Shkencor.

X. Cilësia e punës shkencore – hulumtuese dhe arsimore

Neni 22

Me qëllim të sigurimit të cilësisë së punës shkencore – hulumtuese dhe arsimore, si dhe me qëllim të sigurimit unik të punës shkencore-hulumtuese dhe arsimore, organet kompetente të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan, si edhe të gjithë ligjëruesit dhe bashkëpunëtorët, pandërprerë angazhohen në krijimin, përgatitjen dhe realizimin e programit arsimor, shkencor dhe projektet hulumtuese, në pajtim me:

- » Strategjinë e sigurimit të cilësisë dhe Politikën e cilësisë së Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan;
- » Nevojave dhe pritjeve të shoqërisë;
- » Praktikën më të mirë të institucioneve të huaja arsimore, shkencore dhe hulumtuese;
- » Nevojat për sigurimin e cilësisë dhe të kualitetit në fushat e tjera të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan në të cilat kjo Rregullore është e aplikueshme;
- » Disponimi me resurset e brendshme dhe të jashtme për realizimin e programeve dhe projekteve.

Neni 23

Veprimtaria shkencore-hulumtuese dhe artistike vlerësohen sipas:

- » numrit të publikimeve në tri vitet e fundit;

- » numrit të citimeve nga autorët e huaj (të dhëna nga bazat e citimeve);
- » numrit të përgjithshëm të projekteve të paraqitura në tri vitet e fundit (kombëtare dhe ndërkombëtare);
- » numrit të përgjithshëm të projekteve të realizuara në tri vitet e fundit (kombëtare dhe ndërkombëtare)
- » pjesëmarrjes në seminare, konferenca, këshilla shkencor (vendore dhe ndërkombëtare) në tri vitet e fundit);
- » numrit të përgjithshëm të mbledhjeve të organizuara shkencore në tri vitet e fundit nga ana e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan;

XI. Cilësia e ligjëruesve dhe bashkëpunëtorëve

Neni 24

Sigurimi e cilësisë së ligjëruesve dhe të bashkëpunëtorëve realizohet nëpërmes aktiviteteve adekuate në procesin e udhëheqjes me resurset njerëzore, si në vijim:

- » planifikimit të vazhdueshëm dhe përcjelljes së nevojave për angazhimin e ligjëruesve dhe bashkëpunëtorëve në fushat e ndryshme shkencore – hulumtuese dhe arsimore;
- » përzgjedhja e ligjëruesve dhe bashkëpunëtorëve sipas Statutit dhe Rregullores për Rregullat dhe Procedurat e Punësimit për Stafin e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan, duke i përcaktuar kriteret dhe procedurat;
- » krijimin e kushteve për përsosmërinë e vazhdueshme arsimore dhe shkencore të ligjëruesit dhe të bashkëpunëtorit;
- » përcjelljen permanente dhe të rregullt të vlerësimit të kualitetit në këtë fushë, ashtu siç është e paraparë në këtë Rregullore.

Neni 25

Komisioni për sigurimin e cilësisë, në procesin e vlerësimit të rregullt, nëpërmes *pyetësorëve, anketave, intervistave, monitorimit*, mbledh qëndrimet dhe të dhënat e studentëve për cilësinë dhe kualitetin e ligjëruesve dhe bashkëpunëtorëve në procesin mësimor, në fushat vijuese:

- » mbajtjen e mësimit në pajtim me planin e punës për lëndë;
- » përcjelljen e njohurive dhe ligjëratave interaktive;
- » zhvillon aftësitë e tij përmes synimeve plotësuese në lëndë dhe në programet studimore;
- » përdorimin e teknologjisë së re informative gjatë ligjëratave;
- » motivimin e studentëve për të marr pjesë në ligjërata, punët hulumtuese grupore apo të vetme;
- » kriteret e notimit, nga aspekti i transparencës dhe drejtësisë.

XII. Kriteret për zgjedhjen dhe vlerësimin e cilësisë së kuadrit akademik

Neni 26

Zgjedhja e kuadrit akademik bëhet në pajtim me kriteret dhe procedurat për zgjedhje në tituj mësimor-shkencor, shkencor, mësimor dhe bashkëpunues të përcaktuara me Statutin e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, respektivisht me Rregulloren e Universitetit për kriteret e barabarta dhe procedurat për zgjedhje në tituj mësimor shkencor, dhe bashkëpunues.

Vlerësimi periodik i cilësisë së kuadrit akademik i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, bëhet nga ana e organit për vlerësimin e arsimit të lartë, sipas kësaj Rregulloreje.

Vlerësimi i cilësisë së kuadrit akademik bëhet sipas:

- » Kualifikimeve të kuadrit akademik, në pajtim me aktet e përgjithshmet të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan;
- » Zbatimin në praktikë të kriterëve për përzgjedhjen në nivel të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan;
- » Mbulimi i të gjitha fushave shkencore me kuadër akademik;
- » Realizimi i anketave të rregullta me studentët për kualitetin e kuadrit akademik dhe përfshirja e mendimit të studentëve në portfolion e kuadrit akademik dhe bashkëpunues;
- » Realizimi i mekanizmit motivues dhe shpërblimeve nga Rektorati i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan;
- » Organizimin e kurseve të obligueshme për trajnim dhe zhvillim të kuadrit akademik.

XIII. Masat për përmirësimin e kualitetit

Neni 27

Këshilli mësimor-shkencor i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, i cili kryen veprimtari të arsimit të lartë, në bazë të Raportit të Komisionit dhe të vlerësimit të kualitetit të kuadrit akademik, propozon dhe ndërmer masa për përmirësimin e tyre.

XIV. Cilësia e studentëve

Neni 28

Sigurimin e cilësisë së studentëve, Universiteti e realizon nëpërmes aktiviteteve dhe standardeve në fushat vijuese:

- » selektimi e studentëve me rastin e regjistrimit të tyre;
- » procesit arsimor;
- » organizimit të studentëve;

- » përcjelljen e vazhdueshme dhe vlerësimin e rregullt të kualitetit në këtë fushë në pajtim me këtë Rregullore.

Neni 29

Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan garanton barazinë e të gjithë studentëve, pa marr parasysh racën, ngjyrën, gjininë, nacionalitetin, gjuhën, fenë, mendimin politik etj. Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan i’u mundëson studentëve organizimin dhe veprimtarinë e tyre nëpërmes të organizatës së tyre studentore, konform Statutit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan.

Neni 30

Me qëllim të sigurimit e cilësisë në këtë aspekt, me rastin e regjistrimit të studentëve, aplikohet Rregullorja për përcaktimin e procedurave për regjistrimin e studentëve në Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan.

XV. Cilësia e teksteve shkollore, literaturës, bibliotekës dhe kabineteve informatike

Neni 31

Sigurimi i cilësisë së teksteve shkollore, literaturës, bibliotekës dhe kabineteve të informatikës, është i domosdoshëm në zhvillimin e suksesshëm të procesit arsimor dhe realizohet përmes:

- » sigurimit të teksteve shkollore të cilat mundësojnë realizimin e qëllimeve të përcaktuara sipas programit studimor dhe lëndëve;
- » sigurimin e fondit të mjaftueshëm të literaturës, fond i cili mundëson realizimin e qëllimeve të përcaktuara sipas programit studimor dhe lëndëve;
- » sigurimin e pajisjeve moderne në kabinetin e informatikës për zhvillimin e procesit mësimor dhe për nevojat e studentëve;
- » sigurimin e hapësirës së mjaftueshme për shfrytëzimin efikas të bibliotekës dhe kabinetit të informatikës nga ana e studentëve, ligjëruesve dhe bashkëpunëtorëve të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan.

Neni 32

Komisioni për sigurimin e cilësisë, në procesin e vlerësimin të rregullt, përmes anketimit grumbullon të dhënat dhe qëndrimet e studentëve, ligjëruesve dhe bashkëpunëtorëve, në aspektet vijuese të kualitetit të teksteve shkollore, literaturës, bibliotekës dhe kabinetit të informatikës:

- » pajisja e mjaftueshme me tekste shkollore sipas standardeve akademike dhe vlerësimi sipas ECTS kredive;
- » përmbajtja e teksteve shkollore me të dhëna të mjaftueshme, sipas kërkesa të
- » studentëve gjatë marrjes së diturive në lëndët e caktuara;
- » pajisja e mjaftueshme e bibliotekës me literaturë dhe tekste shkollore dhe mundësia e qasjes së studentëve në bibliotekë;

XVI. Cilësia e udhëheqjes së Universitetit

Neni 33

Cilësia e udhëheqjes së Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan, realizohet nëpërmes aplikimit të plotë dhe të drejtë të Ligjit mbi Arsimin e Lart, Statutit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan dhe akteve të tjera të përgjithshme të universitetit në lidhje me përgjegjësitë dhe autorizimet e të gjitha organeve të universitetit, me qëllim të:

- » realizimit të misionit dhe vizionit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan;
- » sigurimin e cilësisë së punës së Universitetit.

XVII. Cilësia e hapësirës arsimore dhe pajisjeve

Neni 34

Sigurimi i cilësisë së hapësirës arsimore dhe pajisjeve realizohet përmes:

- » sigurimit të hapësirës dhe pajisjeve të teknologjisë së re informative, për realizimin e qëllimeve të kualitetit të procesit arsimor, së paku në pajtim me standardet kombëtare;
- » sigurimin e pandërprerë të lidhjes së internetit dhe lënien në disponim për ligjëruesit, bashkëpunëtorët dhe studentët;
- » përcjelljen e vazhdueshme dhe vlerësimin e kualitetit të këtyre pajisjeve sipas numrit të studentëve si dhe sipas kërkesave për sigurimin e cilësisë së programeve studimore, procesit arsimor dhe procesit hulumtues – kërkimor dhe shkencor të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan;
- » udhëheqjen dhe evidentimin e pajisjeve;
- » aplikimin e masave të përshtatshme për siguri, mbrojtje të shëndetit të punësuarave, studentëve dhe të gjithë personave të tjerë që janë për rreth tyre, në përputhje me ligjin.

XVIII. Cilësia e Financimit

Neni 35

Sigurimi i cilësisë së financimit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan, me qëllim të arritjes së financimit afatgjatë, stabilitetit dhe qëndrueshmërisë, realizohet përmes:

- » sigurimin e burimeve të sigurta të financimit, të cilat duhet të në përputhje me nevojat financiare të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan;
- » aplikimin e metodave adekuate të planifikimit të financimit dhe të përcjelljes së ndryshimeve financiare;
- » participimi – pagesa e studentëve për studime brenda një viti;
- » raportimin para organeve dhe trupave përgjegjëse në përputhje me ligjin dhe këtë rregullore.

Neni 36

Në fund të çdo viti akademik, në përputhje me të dhënat e kontabilitetit dhe të dhënat e tjera financiare, Rektori i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, përgatit propozimin e Raportit Financiar dhe të Planit Financiar për vitin vijues si dhe të gjitha dokumentet e tjera financiare dhe ia propozon Këshillit Mësimor Shkencor për miratim.

XIX. Bashkëpunimi i jashtëm, kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Neni 37

a. Bashkëpunimi nacional vlerësohet sipas:

- » bashkëpunimit me ekonominë, me institucionet qeveritare dhe me asociacionet tjera profesionale nacionale, e në kontekst të misionit, qëllimeve dhe detyrave të institutit;
- » numrit të përgjithshëm të projekteve në pesë vitet e fundit;
- » kontakteve dhe bashkëpunimit me studentët e diplomuar dhe me asociacionet e tyre;
- » kontakteve me punëdhënësit;

b. Bashkëpunimi ndërkombëtar vlerësohet sipas:

- » pjesëmarrjes në programe arsimore evropiane (Tempus, Erasmus, Mundus e të tjera në tri vitet e fundit;
- » dimensionit ndërkombëtar të programeve studimore;
- » shkëmbimit të kuadrit akademik me qendrat e tjera akademike në vend dhe jashtë;
- » shkëmbimi i studentëve me qendra tjera akademike në vend dhe jashtë mësimi në gjuhë të huaja;
- » shfrytëzimi i literaturës së huaj.

c. Marrëdhëniet me publikun vlerësohen sipas

- » ditëve të hapura të institutit për njohjen e studentëve të ardhshëm me mundësitë për studim në institut;
- » bashkëpunimit me mediumet e shkruara dhe elektronike;
- » pjesëmarrja në panairë për arsimim

XX. Përmbajtja e raportit të Vetëvlerësimit

Neni 38

Pas realizimit të vetëvlerësimit në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan, Komisioni për vetëvlerësim përgatit raportin për vetëvlerësim në mënyrë të hapur dhe publike me përfshirjen e të gjitha mangësive. Gjatë përgatitjes së raportit, Komisioni për vetëvlerësim duhet të ketë parasysh se në raport duhet të merren parasysh të gjitha faktet për programet studimore dhe programet e lëndëve

Raporti për vetëvlerësim përbëhet prej dy pjesëve: pjesës përshkruese dhe pjesës së indikatorëve të matshëm, me të gjitha të dhënat respektive kuantitative adekuate:

- » hyrja, ku sqarohet procesi i vetëvlerësimit;
- » lista e anëtarëve të komisionit dhe grupeve punuese të cilët kanë marrë pjesë në vetëvlerësim;
- » lista e organeve, subjekteve dhe institucioneve me të cilët instituti ka bashkëpunuar në vetëvlerësim;
- » paraqitja e elementeve pozitive dhe e vështirësive që janë paraqitur gjatë procesit të vetëvlerësimit;
- » në pjesën për studentët dhe profesionistët e diplomuar, raporti duhet të përmbaj të dhënat, idetë, komentet dhe sugjerimet, e dhëna nga studentët për të gjitha aspektet e sigurimit të kualitetit, me çka at munden të ndihmojnë në procesin e vetëvlerësimit dhe të përmirësohet procesi i vlerësimit. Nga pikëpamja praktike, ideja e studentëve mund të merret në disa mënyra: përmes diskutimeve të lira, bisedimit me ata në “katër sy”, përmes anketave të ndryshme me studentë, takimeve me organet udhëheqëse studentore, ide në formë të shkruar, apo kombinime të ndryshme të propozimeve të lartpërmendura;
- » pjesa për studentët në raport duhet të paraqes tërësi të posaçme. Është shumë i rëndësishëm numri i studentëve të mos jetë selektiv, por ti përfaqësoj interesat e tyre në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan dhe në programin studimor në cilin ata studiojnë.

Pikë fillestare e analizës janë misioni dhe qëllimet e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, ku ato vërtetohen dhe vlerësohen. Analizat i ndriçojnë anët e forta dhe të dobëta të secilës komponentë që është objekt i vetëvlerësimit. Analizat përcillen me propozime dhe me plan korrigjues të aktiviteteve për eliminimin e mangësive dhe për përmirësimin e kualitetit.

XXI. Përfundimi i Raportit të Vetëvlerësimit

Neni 39

Përfundimi i raportit për vetëvlerësim i ka këto karakteristika:

- » të jetë sa më shumë objektiv, i sigurtë dhe i hapur, duke pasur parasysh se qëllimi i vetëvlerësimit është përmirësimi i kualitetit;

- » të jetë krahasim përfundimtar me proceset e përfunduara më herët për vetëvlerësim dhe vlerësim të jashtëm, dhe të zbatohet analiza e përparimit në krahasim me mangësitë e konstatuara nga proceset e vlerësimit të realizuara më herët për aspekte të caktuara;
- » të shprehen në mënyrë eksplicite anët e forta dhe të dobëta të Institutit dhe ti shmanget theksimit të anëve pozitive apo mosparaqitjen e anëve negative;
- » anët e forta dhe të dobëta që nuk janë diskutuar në fillim të raportit të mos publikohen në konkluzione sepse do të mbeten të pa arsyetuara dhe do ti transformojnë konkluzionet në lobim të një pjese të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan;
- » anët e forta dhe të dobëta të cilat nuk janë diskutuar në pjesën kryesore të raportit të mos paraqiten as në përfundim;
- » planet për përmirësim të ofrohen në formë të masave konkrete. Në përfundim të raportit për vetëvlerësim në mënyrë obliguese duhet të cekën masat që duhet të ndërmerren sipas rezultateve të vlerësimit.

XXII. Madhësia e Raportit të Vetëvlerësimit

Neni 40

Madhësia e raportit për vetëvlerësim është prej 15 deri në 25 faqe, pa shtojca.

XXIII. Nënshkrimi i Raportit të Vetëvlerësimit

Neni 41

Raportin për vetëvlerësim e nënshkruan Kryetari dhe anëtarët e komisionit për vetëvlerësim dhe ai i dorëzohet Rektorit të Universitetit dhe Prorektorit për mësim. Raporti dërgohet edhe tek Këshilli Mësimor Shkencor për vlerësim dhe në tek institucionet për vlerësim të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës.

XXIV. Qasja e Raportit të Vetëvlerësimit për pjesëmarrësit në vlerësim

Neni 42

Raporti për vetëvlerësim duhet të jenë në dispozicion të të gjithë anëtarëve në mbledhjet që do të mbahen gjatë kohës së vizitës në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan, nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), komisioni për vlerësim i universitetit apo ekipit të saj si dhe nga trupi për vlerësim të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës apo ekipit të tij.

XXV. Publikimi i Raportit të Vetëvlerësimit

Neni 46

Raporti për vetëvlerësim të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan publikohet në mënyrë adekuate në revistën zyrtare të universitetit.

XXVI. Hyrja në fuqi e Rregullores

Neni 47

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Mësimor Shkencor dhe nënshkrimi nga ana e Rektorit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan.



Rektori
Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi